

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në formimin e gjyqimeve të përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomike e sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë përparimin e INSTAT-it në forcimin e sistemit kombëtar statistikor, harmonizimin me standardet evropiane dhe zgjerimin e qasjes publike në informacion statistikor cilësor e të verifikuar.

Duke vlerësuar se statistikatat zyrtare shpërndahen në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke garantuar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare, brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar, si dhe për të siguruar krahasueshmëri me vendet e tjera të rajonit dhe të Evropës;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Realizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, me mbulim rreth 97% të popullsisë dhe publikimin e rezultateve paraprake e të detajuara sipas kalendarit zyrtar dhe shoqërimit të procesit me një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore për monitorim në kohë reale të intervistimeve.

Zhvillimit të platformës “*Geodata Hub*” dhe komponentit “*Web GIS*”, që mundësojnë akses publik dhe institucional në të dhënat gjeohapësinore, duke forcuar përdorimin e informacionit statistik për planifikim dhe analiza territoriale.

Digjitalizimit dhe inovacionit teknik në proceset statistikore përmes përdorimit të pajisjeve elektronike dhe integritetit të burimeve administrative të të dhënave, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Rishikimit të llogarive kombëtare në vitin 2024, në bashkëpunim me Eurostat, përfshirë për herë të parë Tabelat e Furnizim-Përdorimit dhe llogaritë e sektorëve institucionale, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë, krahasueshmërinë dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së (ESA 2010).

Zgjerimit të Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS) me përfshirjen e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si prodhues zyrtar të statistikave të energjisë, dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR) për shkëmbimin e të dhënave për rininë, duke forcuar koordinimin ndërinstitucional dhe unifikimin e standardeve metodologjike.

Rritjes së cilësisë dhe sasisë së të dhënave të transmetuara në Eurostat, përfshirë llogaritë kombëtare vjetore dhe rajonale, tregtinë e jashtme dhe statistikatat fiskale (EDP/GFS), të cilat sipas Komisionit Evropian kanë shënuar përmirësime të ndjeshme në prodhim dhe raportim.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë puna për publikimet tematike “Post Census”, me analiza që u përgjigjen nevojave të politikave publike, planifikimit vendor dhe kërkimit shkencor, dhe të përditësohet platforma e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

2. Të rrisë numrin e treguesve në platformën “*Geodata Hub*” dhe “*Web GIS*”, si dhe të zhvillohen materiale orientuese dhe tutoriale për përdorues joteknikë, veçanërisht për njësitë e statistikave vendore dhe planifikuesit urban.

3. Të vijojë përgatitjet për realizimin e Censit të Ekonomive Bujqësore, ndjekur nga një strategji organizimi, kalendar të aktiviteteve dhe burime të përcaktuara financimi. Të bashkëpunohet me Ministrinë e Bujqësisë, FAO, Eurostat dhe të ndërmarrë një fushatë informuese për fermerët.

4. Të vazhdojë të udhëheqë koordinimin teknik dhe institucional me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për përgatitjen e *metadata*-ve me standardet e FMN-së dhe përshtatjen e treguesve sipas SDDS.

5. Të vazhdojë punën për përmirësimin e llogarive sektoriale dhe financiare sipas standardeve të ESA 2010 dhe të sigurojë transmetimin në Eurostat.

6. Të përmirësojë statistikën mjedisore dhe të energjisë përmes zhvillimit të llogarive për emetimet në ajër, flukset fizike të energjisë dhe taksat mjedisore sipas sektorëve ekonomikë.

7. Të hartojë një kornizë strategjike për përdorimin e metodave moderne në prodhimin statistikor, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve në kohë dhe të detajuara.

8. Të mbajë aktive dhe të përditësojë rregullisht faqen e INSTAT-it në të gjitha kategoritë: statistika, publikime dhe dokumentim, si mjeti kryesor i aksesueshmërisë dhe komunikimit të INSTAT-it.

9. Të shpallë vakancat dhe të rekrutojë sa më shpejt stafin sipas sektorëve që paraqesin mangësi.

10. Të përmirësojë mbledhjen e statistikave për kërkimin dhe inovacionin duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat, mbështetur në manualët metodologjike të *Frascati*-t dhe *Oslo*-s.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.10.2025.